

Vendim nr. 201 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

| | |
|-------------------|----------|
| Holta Zaçaj, | Kryetare |
| Sonila Bejtja, | Anëtare |
| Genti Ibrahimimi, | Anëtar |

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 16 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: PËRPARIM CELIBASHI

OBJEKTI: Plotësimi i vendimit nr. 114, datë 24.05.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 14, 18, 42, 43 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 313 i Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar (*KPC*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me kërkesën e datës 23.04.2024 kërkesuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, me objekt “*Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-4461, datë 17.10.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Konstatimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Dëmshpërblimin 10.000 (dhjetë mijë) euro, sipas*

nenit 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe paragrafit 204 të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) të datës 11 janar 2018”.

2. Në kërkesë, në mënyrë të përmbledhur, është pretenduar cenimi i së drejtës për proces të rregullt në drejtim të standardit të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë dhe së drejtës për sigurime shoqërore, si dhe është kërkuar dëmshpërblim 10.000 (dhjetë mijë) euro sipas parashikimeve të nenit 44 të Kushtetutës.

3. Me vendimin nr. 114, datë 24.05.2024, Kolegji ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se nga ana e kërkuarit nuk janë shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe për rrjedhojë ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

4. Në arsyetimin e tij, Kolegji, ndër të tjera, ka vlerësuar se *“duke qenë se kërkuari ka pretenduar kohëzgjatje të paarsyeshme nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se nuk rezulton që ai t’i jetë drejtuar asaj gjykate me kërkesë për konstatimin e gjykimit të çështjes tej afatit të arsyeshëm, sipas nenit 399/6, shkronja “c”, të KPC-së, për rrjedhojë vlerësohet se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim”.*

5. Pasi është njohur me këtë vendim, në datën 05.07.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës me kërkesën nr. 16 (P) 2024 për plotësimin e vendimit nr. 114, datë 24.05.2024 të Kolegjit.

II

Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar këto shkaqe për plotësimin e vendimit:

6.1. Gjykata nuk është shprehur nëse ka apo jo cenim të afatit të arsyeshëm për gjykimin e çështjes së tij nga ana e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

6.2. Nuk është konstatuar fakti se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i papajtueshëm me Kushtetutën.

6.3. Nuk është trajtuar kërkesa e tij për dëmshpërblim në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro, sipas parashikimeve të nenit 44 të Kushtetutës, si dhe nuk përmendet vendimi i GJEDNJ-së i datës 11 janar 2018, i cili zbaton plotësisht nenin 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, duhet që Gjykata të shprehet se kush është organi kompetent që duhet të japë dëmshpërblimin e kërkuar.

- 6.4. Në vendimin e Kolegjit nuk është trajtuar “sjellja e autoriteteve”, por vetëm “sjellja e kërkuarit”, duke krijuar dy standarde të ndryshme.
- 6.5. Vendimi i Kolegjit nuk përmban në dispozitiv të drejtën e kërkuarit për t’u ankuar në GJEDNJ për vendimin.
- 6.6. Në vendim përmenden fjalë dhe shprehje në gjuhë të huaj, të cilat duhet të zëvendësohen me fjalë në gjuhën shqipe.
- 6.7. Në vendim duhet të përmendet fakti se me reformën në ushtri i është mohuar dhe hequr nga shteti përjetësisht e drejta e profesionit, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e barazisë para ligjit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

7. Neni 133, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 përcaktojnë se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet fillimisht fazës së shqyrtimit paraprak të kërkesës, ku vlerësohet nëse kërkesa e paraqitur duhet të pranohet për gjykim në seancë plenare. Në përputhje me këtë dispozitë kushtetuese, rregullat e detajuara të procedurave të gjykimit kushtetues përcaktohen nga ligji nr. 8577/2000 dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës (*Rregullorja*), të cilat kanë parashikuar në dispozita të posaçme edhe kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjykimit kushtetues. Në kuptim të këtyre parashikimeve, një prej rasteve në të cilin mund të vihet në lëvizje Gjykata për të shqyrtuar vendimmarrjet e saj, është kur kërkohet saktësimi dhe plotësimi i vendimit me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (*neni 80 i ligjit nr. 8577/2000*). Ky parashikim është detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimet e Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohen, por veçse mund të saktësohen, plotësohen ose ndreqen gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në to.

8. Kolegji vëren se kërkuari, pasi është njohur me vendimin nr. 114, datë 24.05.2024 të Kolegjit, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për plotësimin e tij, duke pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimi nuk shprehet lidhur me konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm ligjor, nuk konstaton nëse vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është apo jo i pajtueshëm me Kushtetutën, si dhe nuk trajton kërkesën e tij për dëmshpërblim.

9. Kolegji, nën dritën e dispozitave të mësipërme, në raport me rrethanat dhe faktet e rastit konkret në shqyrtim, evidenton se edhe pse në objekt të kërkesës është kërkuar plotësimi i vendimit të Kolegjit të Gjykatës, pretendimet e kërkuarit, në thelb, kanë të bëjnë me mënyrën se si Kolegji ka vlerësuar kriteret e legjitimitetit në drejtim të kërkimeve të paraqitura në atë kërkesë, duke mos qenë dakord me këtë vlerësim dhe duke pretenduar se ai është rrjedhojë e evidentimit të pasaktë e jo të plotë të rrethanave, fakteve dhe dispozitave ligjore. Kolegji vëren, po kështu, se kërkuari e ka mbështetur kërkesën e tij mbi të njëjtat shkaqe dhe pretendime të parashtruara në kërkesën e shqyrtuar me vendimin nr. 114, datë 24.05.2024 të Kolegjit, duke u ndalur në mënyrën se si ato janë analizuar dhe vlerësuar dhe mbi bazën e një analize dhe interpretimi të ndryshëm ka vënë në dyshim mënyrën e vlerësimit të Kolegjit në drejtim të kriterëve të legjitimitetit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

10. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pavarësisht se objekti i kërkesës në shqyrtim është plotësimi i vendimit nr. 114, datë 24.05.2024 të Kolegjit të Gjykatës, pretendimet e parashtruara prej kërkuarit nuk kanë të bëjnë me asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 43 të Rregullores, pra me gabime në shkrim, në llogari ose pasaktësi në vendimin objekt kërkesë. Për rrjedhojë, për sa kohë vendimet e kësaj Gjykate nuk mund të bëhen objekt kontrolli ose rishikimi as nga vetë ajo, përveç rasteve të përcaktuara në këtë rast në mënyrë të shprehur në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në kushtet kur kërkuari nuk ka argumentuar se ndodhet përpara ndonjërit prej këtyre rasteve, Kolegji vlerëson se ai nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës me kërkesën në shqyrtim.

11. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.